



2021

RAPORT – TM1 -2021



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A


Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	3
I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	2
1.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	4
1.1.1 Situata e furnizimit - TM1- 2021	4
1.1.2 Aktivitetet kryesore	4
1.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	8
1.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	8
1.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	8
II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	9
2.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“- Performancat	9
2.1.1 Aktivitetet kryesore- TM1- 2021	14
2.1.2 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shqyçjes	14
2.1.3 Raport I ankesave teknike dhe komerciale	14
2.1.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	15
2.1.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	15
2.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	16
III. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIARË	16
3.1 Komentet- Sherbimi i Financave	16
3.1.1 Aktivitetet kryesore – TM1- 2021	16
3.1.2 Arsyeshmëria e shpenzimeve	17
3.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	18
3.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	19
3.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	19
3.1.6 Transaksionet kryesore	20
IV RAPORT I SHËRBIMIT TË ADMINISTRATËS	21
V RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM	31
VI. AKTIVITETET E ZYRES SE PROKURIMIT	33
ORGANOGRAMI	34

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2020



Punoi: Shërbimi TEKNIK

LEGJENDA:

05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
71	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
122	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

I. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

1.1 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT – JANAR - MARS 2021

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regjional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha Njësitë Punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania ka arritur që në muajt Janar-Mars të vitit 2021 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në ditë. Duhet theksuar se në muajt Janar-Mars në disa pjesë rurale në nivel regjional kemi keqpërdorime enorme të ujit të pijes, prandaj dhe kemi planifikuar restreksione në disa fshatra në nivel regjional. Për me gjëresisht janë prezente tabelat e reduktimeve nga njesite operuese të cilen mund ta gjeni në njesite perkatese.

Në njësitë tjera operuese si në Suharekë, Malishevë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes në pjesët urbane, mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese për shkak të keqpërdorimeve kemi aplikuar reduktime të planifikuara si dhe në varesi të defekteve të mundshme dhe ndërprerjeve të energjisë elektrike nga KEDS kemi ndërprerje të furnizimit me ujë të pijes (për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive).

Vlen të ceket se në muajt Janar-Mars në nivel regjional kemi patur ndërprerje të ujit për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, prandaj si Departament Teknik sygjerojmë që furnizimi me energji elektrike të jetë prioritet nga ana e KEDS-it.

Në muajt Janar-Mars në përgjithësi kemi patur furnizim të rregullt me ujë të pijës dhe aktivitete të duhura në mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, furnizimi me ujë të pijës ka qenë 24 ore/ditë, duke garantuar shtypjen e nevojshme dhe cilësi të ujit 100%.

1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

Menaxheri Teknik

- Nënshkrimi i kontratës së punës – nr. pr. 298/08.02.2021.
- Njoftimi me stafin, detyrat e tyre të punës, organizimin brenda DT, aktivitetet aktuale dhe në vijim, dokumentacioni i arkivuar dhe relevant, zyret, paisjet, automjetet, infrastruktura përcjellëse e të ngjajshme, risistemimi dhe evidentimi i tyre.
- Riorganizimi i stafit sipas nënsektorëve dhe zëvendësimet e kompletimet e ekipeve punuese me punëtor brenda shërbimit respektivisht për punëtorin e pensionuar dhe punëtorëve në mungesë, shoqëruar me dokumentacionin administrativ adekuat.
- Angazhimet e përditshme dhe menaxhimet e punëve në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e vendit të punës dhe jashtë tij për operim dhe funksionimit optimal të shërbimit teknik dhe Kompanisë.
- Raportet.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet në platformen dixhitale si ajo e organizuar nga Shukos (12.02.2021÷15.02.2021) e të tjera, shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike.
- Evaluimet teknike me bashkëpunetoret e DT të projekteve të paperfunduara, ato në ekzekutim e sipër, aplikacionet softwerike dhe menaxheriale, etj.

- Harmonizimi dhe finalizimi i shkresave zyrtare që leshon DT- Pergjigjeve ne kerkesa, Lejeve, Vendimeve dhe Pelqimeve konform Rregulloreve te Kompanise.
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet me donatore, me institucionet komunale, qeveritare, e ngjajshme, shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike.
- Menaxhimi i projektit: “Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”, sipas programit: Faza V - Mënjanimi i ujërave të zeza në Europën Jugperëndimore që është në përmbyllje, investuar nga KFW dhe Qeveria e Kosovës.
- Faza e përmbylljes së projektit: “Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”, procedimi i shkresës për aplikimin e ndeshkimeve dhe urdheresës për afatin shtesë VO-2 prej 46 ditësh pa kosto financiare.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak. në cilësinë e menaxherit të projekteve dhe menaxhimi i kontratave me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë të shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave e parallogarive, kujdesi për mbartëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

* Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- Identifikimin dhe menxhimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Prodhimi i ujit m³ - Janar - Mars, 2021

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	2,604,100.00	28,934.44	334.9	
Suharekë	622,609.00	6,917.88	80.1	
Dragash	233,522.00	2,594.69	30.0	
Malishevë	367,540.00	4,083.78	47.3	
Total	3,827,771.00	42,530.79	492.3	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar - Mars, 2021

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	345	167	512
Suharekë	88	48	136
Dragash	07	04	11
Malishevë	118	84	202
Total	558	303	861

Zyra për planifikim dhe zhvillim – JANAR-MARS, 2021

AKTIVITETET KRYESORE

- * Mbikqyrje në projektet e CDI-së në qytetin e Prizrenit dhe zonat rurale të Prizrenit.
 - * Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
 - * Mbikqyrje në projektin "Inspektimi me CCTV" nga KWE (sistemi i kanalizimit).
 - * Digjitalizimi i konsumatoreve në GIS për njësit e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
 - * Takim pune virtuale me SHUKOS për Vlerësimin e nevojave për trajnime me datë: 02.02.2021 dhe 09.02.2021.
 - * Takim pune virtuale me SHUKOS për Menaxhimin e Integruar të Aseteve me datë: 12.02.2021 dhe 15.02.2021.
 - * Takim pune me kryetarin e Mamushës me datë: 09.02.2021 për funksionalizimin e sistemit të rrjetit të ujit për Mamushën.
 - * Auditimi nga ARRU për vitin 2020 me datë: 11.02.2021.
 - * Gjatë muajve Janar - Mars grupi ka vazhduar me përpunimin e të dhënave të terrenit, vendosjen e të dhënave në GIS.
- Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e Kompanisë dhe në një Hardisk të jashtëm për rast sigurie.
- * Verifikimi i konsumatoreve në hartë, regjistrimi i të dhënave (kons.emri dhe mbiemri), regjistrimi i rekordeve që nuk kanë numër të rekordeve në hartë, futja e shënimeve në rekorde të reja (kons.emri dhe mbiemri) si dhe lidhja e rekordeve Navizhen – GIS.
 - * Grupi i riparimit dhe kalibrimit të ujëmatësave gjatë muajve Janar-Mars kanë arritur që gjithsej të bëjnë: 177 riparime të ujëmatësave, 6 ekspertiza dhe leximin e ujëmatësave. Ekziston raporti i veçantë.
 - * Në muajt Janar-Mars, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 222 ujëmatësa, ekziston raporti i veçant.
 - * Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar-Mars, ka bërë gjithësej 187 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 139 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 6,318 m.
 - * Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Janar Mars, ujëmatësat në pikat matëse: Fehmi Lladroci, të ETC-ja, Jusuf Gervalla dhe Gorozhup ska lexim, Të KFORI, FSK-ja, Kobaj, Nashec i epërm, Tupec, Grazhdanik dhe Atmaxhë pusetat me ujë, Gjonaj i poshtem dhe Gjonaj i epërm janë vendosur ujëmatësat e rinjë, Kojush II rruga e bllokuar, Landovicë lexim i ulet. Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këtë muaj.
 - * Në muajin Janar-Mars, grupi i bllobimit të ujëmatësave kanë arritur që gjithsej të bëjnë:

1	Bllombim-Kontrata	336
2	Dera Mbyllur	1027
3	Ribllombim	567
4	Kërkes nga konsumatori	27
5	Regjistrim i ri	15
6	Duhet regjistruar	01
7	Zevendesim	08

Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike Janar-Mars, 2021

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje, qytet e fshatra.

Kontrolli përmanet i kualitetit të ujit në burime dhe puse të cilat shfrytëzohen për momentin.

Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.

Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit intern .

Bëmë riparimin si dhe zevendesimin e pompes per klorifikim në komorën e re në "40 Burime", në gypin Ø600mm.

Bëmë riparimin e sistemit të klorinimit në stacionin „Pusi i Atit” ku ndërruam vakum rregullatorin , rrotometrën dhe injektorin për arsye se të më parshmit ishin jashtë funksionit si pasoj e vjetërsisë së tyre.

Kontrolle të vazhdueshme 24 orë në "40 Burime" për shkak të reshjeve të mëdha dhe rritjes së turbiditetit dhe mundësisë së futjes në sistem sa ma parë që është e mundur burimet të cilat ishim të detyruar që ti largonim nga rrjeti.

Te stacioni i klorinimit në „Bunar-1”ndërruam pjes fazonike(ventil) afër pompës së klorinimit.

Në fshatin Gjonaj riaktivizuam sistemin e klorinimit te komora mbledhëse nga „Gurra”.

Monitoruam dhe raportuam mbi punët e kryera nga punë kryesi „Diamanti”mbi aparaturat e vendosura për klorinim të ujit të pijes në zona rurale (faza e dytë).

Kemi riaktivizuar sistemin e tushave në stacionin e klorinimit, si masë e krijimit të sigurisë në punë në raste avarie me klor.

Në rezervuarin e Zhur-it kemi instaluar komplet paisjet për një qeshme e cila nevojitet për krijimin e tretësisë se Hipokloritit të Natriumit.

Analizat Bakteriologjike, Janar - Mars / 2021

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	13	10
	Ujësjellës	32	2
Suharekë	Burim	1	0
	Ujësjellës	9	1
Dragash	Burim	3	3
	Ujësjellës	8	0
Malishevë	Burim	3	3
	Ujësjellës	7	0
Totali		76	3

Vrejtje: 1) Në burim, uji i patrajtuar ; 2) Ujësjellës, uji i trajtuar
(Sh.Teknike."Skënder Luarasi", Suharekë me datë: 11.02.2021)

Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, Janar - Mars / 2021

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	2	0
	Ujësjiellës	204	0
Suharekë	Burim	0	0
	Ujësjiellës	27	0
Dragash	Burim	0	0
	Ujësjiellës	12	0
Malishevë	Burim	2	0
	Ujësjiellës	28	0
Totali		271	0

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjiellës është 271 mostra dhe të gjitha mostrat i përgjigjen standarteve të ISHP.

1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjellesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit,
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjellesit dhe kanalizimit si dhe bartja e te dhenave ne GIS,
- Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se.

*Aktivitete e shërbimit teknik të ndermarrura për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjeter të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjiellësit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujin në menyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve në sherbime dhe investime për sherbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

II. RAPORT NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

2.1 RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE

TM - 4 / 2020 - TM - 1 / 2021

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM4-2020	TM1-2021	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	2,699,800	2,604,100	(95,700)	-3.54
<i>Faturimi m3</i>	1,410,885	1,325,661	(85,224)	-6.04
<i>Faturiminguaji €</i>	855,103.09 €	803,123.56 €	- 51,979.53 €	-6.08
<i>Faturimi- tetjera €</i>	11,721.69 €	26,463.36 €	14,741.67 €	125.76
<i>Faturimi Total €</i>	866,824.78 €	829,586.92 €	- 37,237.86 €	-4.30
<i>Inkasiminguaji €</i>	959,057.13 €	934,020.73 €	- 25,036.40 €	-2.61
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	5,225.75 €	19,870.72 €	14,644.97 €	280.25
<i>Inkasimi Total €</i>	964,282.88 €	953,891.45 €	- 10,391.43 €	-1.08
<i>Nr. iKonsumatorëve</i>	36,303	36,606	303	0.83
<i>% e inkasimit</i>	112.16	116.30	4.1	3.69
<i>Shpenzimet</i>	823,480.57 €	745,605.14 €	- 77,875.43 €	-9.46
<i>Pagat</i>	462,738.19 €	438,103.02 €	- 24,635.17 €	-5.32
<i>Rrymaelektrike</i>	165,314.25 €	147,216.49 €	- 18,097.76 €	-10.95
<i>Shpe. e derivateveve</i>	20,590.54 €	16,025.43 €	- 4,565.11 €	-22.17
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	37,716.93 €	38,429.14 €	712.21 €	1.89
<i>Miremb. e automjeteve</i>	16,392.34 €	5,713.89 €	- 10,678.45 €	-65.14
<i>Shpen. E taksave</i>	24,513.48 €	27,045.14 €	2,531.66 €	10.33
<i>Kemikalet</i>	3,621.73 €	2,946.62 €	- 675.11 €	
<i>Shpenzimet tjera</i>	92,593.11 €	70,125.41 €	- 22,467.70 €	-24.26
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	1,288,915	1,278,439	(10,476)	-0.81
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	47.74	49.09	1.35	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.17	1.28	0.11	

140,802.31 € 208,286.31 €

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM4-2020 - TM1- 2021

• **NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË**

MUAJI	TM4-2020	TM1-2021	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	640,918	622,609	(18,309)	-2.86
<i>Faturimi m3</i>	208,819	242,308	33,489	16.04
<i>Faturimingauji €</i>	132,524.17 €	149,082.72 €	16,558.55 €	12.49
<i>Faturimi- tetjera €</i>	1,220.17 €	1,170.00 €	- 50.17 €	-4.11
<i>Faturimi Total €</i>	133,744.34 €	150,252.72 €	16,508.38 €	12.34
<i>Inkasimingauji €</i>	149,034.29 €	131,219.78 €	- 17,814.51 €	-11.95
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	1,639.68 €	1,140.29 €	- 499.39 €	-30.46
<i>Inkasimi Total €</i>	150,673.97 €	132,360.07 €	- 18,313.90 €	-12.15
<i>Nr. iKonsumatorëve</i>	8,643	8,689	46	0.53
<i>% e inkasimit</i>	112.46	88.02	(24.4)	-21.73
<i>Shpenzimet</i>	112,090.03 €	108,318.17 €	- 3,771.86 €	-3.37
<i>Pagat</i>	64,479.84 €	60,204.30 €	- 4,275.54 €	-6.63
<i>Rrymaelektrike</i>	35,887.94 €	32,919.20 €	- 2,968.74 €	-8.27
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,888.98 €	1,720.37 €	- 1,168.61 €	-40.45
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	2,165.42 €	8,671.51 €	6,506.09 €	300.45
<i>Miremb. e automjeteve</i>	3,430.80 €	1,590.47 €	- 1,840.33 €	-53.64
<i>Shpen. E taksave</i>	- €	10.00 €	10.00 €	#DIV/0!
<i>Kemikalet</i>	607.62 €	607.62 €	- €	0.00
<i>Shpenzimetjtjera</i>	2,629.43 €	2,594.70 €	- 34.73 €	-1.32
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	432,099	380,301	(51,798)	-11.99
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	67.42	61.08	(6.34)	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.34	1.22	(0.12)	

38,583.94 € 24,041.90 €

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM4-2020 -TM1- 2021

• **NJËSIA PUNUESE - DRAGASH**

MUAJI	TM4-2020	TM1-2021	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	252,839	233,522	(19,317)	-7.64
<i>Faturimi m3</i>	34,384	41,104	6,720	19.54
<i>Faturiminguaji €</i>	22,716.99 €	28,399.81 €	5,682.82 €	25.02
<i>Faturimi- tetjera €</i>	365.00 €	112.00 €	- 253.00 €	-69.32
<i>Faturimi Total €</i>	23,081.99 €	28,511.81 €	5,429.82 €	23.52
<i>Inkasiminguaji €</i>	28,963.07 €	29,047.12 €	84.05 €	0.29
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	558.03 €	393.25 €	- 164.78 €	-29.53
<i>Inkasimi Total €</i>	29,521.10 €	29,440.37 €	- 80.73 €	-0.27
<i>Nr. iKonsumatorëve</i>	1,506	1,509	3	0.20
<i>% e inkasimit</i>	127.50	102.28	(25.2)	-19.78
<i>Shpenzimet</i>	32,813.04 €	30,811.27 €	- 2,001.77 €	-6.10
<i>Pagat</i>	29,043.49 €	28,068.79 €	- 974.70 €	-3.36
<i>Rrymaelektrike</i>	1,618.11 €	1,896.51 €	278.40 €	17.21
<i>Shpe. e derivateveve</i>	290.84 €	201.11 €	- 89.73 €	-30.85
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	408.19 €	160.09 €	- 248.10 €	-60.78
<i>Miremb, e automjeteve</i>	485.30 €	75.24 €	- 410.06 €	-84.50
<i>Shpen. E taksave</i>	250.00 €	- €	- 250.00 €	
<i>Kemikalet</i>	- €	- €	- €	
<i>Shpenzimet tjera</i>	717.11 €	409.53 €	- 307.58 €	-42.89
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	218,455	192,418	(26,037)	-11.92
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	86.40	82.40	(4.00)	
<i>Mbulimioperativ</i>	0.90	0.96	0.06	

- 3,291.94 € - 1,370.90 €

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM4-2020 -TM1- 2021

• NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM4-2020	TM1-2021	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	364,668	367,540	2,872	0.79
<i>Faturimi m3</i>	141,512	118,567	(22,945)	-16.21
<i>Faturimingauji €</i>	93,365.73 €	81,300.01 €	- 12,065.72 €	-12.92
<i>Faturimi- tetjera €</i>	6,901.97 €	1,786.81 €	- 5,115.16 €	-74.11
<i>Faturimi Total €</i>	100,267.70 €	83,086.82 €	- 17,180.88 €	-17.14
<i>Inkasimingauji €</i>	96,392.05 €	99,501.21 €	3,109.16 €	3.23
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	14,163.81 €	1,924.81 €	- 12,239.00 €	-86.41
<i>Inkasimi Total €</i>	110,555.86 €	101,426.02 €	- 9,129.84 €	-8.26
<i>Nr. iKonsumatorëve</i>	5,870	5,897	27	0.46
<i>% e inkasimit</i>	103.24	122.39	19.1	
<i>Shpenzimet</i>	98,703.15 €	92,641.02 €	- 6,062.13 €	-6.14
<i>Pagat</i>	59,245.48 €	55,694.56 €	- 3,550.92 €	-5.99
<i>Rrymaelektrike</i>	28,283.83 €	25,259.28 €	- 3,024.55 €	-10.69
<i>Shpe. e derivateveve</i>	3,092.16 €	1,395.02 €	- 1,697.14 €	-54.89
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	5,467.52 €	5,622.71 €	155.19 €	2.84
<i>Miremb, e automjeteve</i>	514.59 €	2,039.16 €	1,524.57 €	296.27
<i>Shpen. E taksave</i>	59.61 €	236.61 €	177.00 €	296.93
<i>Kemikalet</i>	743.44 €	620.07 €	- 123.37 €	
<i>Shpenzimet tjera</i>	1,296.52 €	1,773.61 €	477.09 €	36.80
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	223,156	248,973	25,817	11.57
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	61.19	67.74	6.55	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.12	1.09	(0.03)	
	11,852.71 €	8,785.00 €		

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM4-2020 -TM1- 2021

● **HIDROREGJIONI JUGOR**

MUAJI	TM4-2020	TM1-2021	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,958,225	3,827,771	(130,454)	(3.30)
<i>Prodhimi - l/sec</i>	503	492	(11.18)	(2.22)
<i>Faturimi m3</i>	1,795,600	1,727,640	(67,960)	(3.78)
<i>Faturimi l/sec</i>	228	222	(6.2)	(2.72)
<i>Faturiminguaji €</i>	1,103,709.98 €	1,061,906.10 €	- 41,803.88 €	(3.79)
<i>Faturimi- tetjera €</i>	20,208.83 €	29,532.17 €	9,323.34 €	46.13
<i>Faturimi Total €</i>	1,123,918.81 €	1,091,438.27 €	- 32,480.54 €	(2.89)
<i>Inkasiminguaji €</i>	1,233,446.54 €	1,193,788.84 €	- 39,657.70 €	(3.22)
<i>Inkasimi - tetjera €</i>	21,587.27 €	23,329.07 €	1,741.80 €	8.07
<i>Inkasimi Total €</i>	1,255,033.81 €	1,217,117.91 €	- 37,915.90 €	(3.02)
<i>Nr. iKonsumatorëve</i>	52,322	52,701	379	0.72
<i>% e inkasimit</i>	111.75	112.42	0.66	
<i>Shpenzimet</i>	1,067,086.79 €	977,375.60 €	- 89,711.19 €	(8.41)
<i>Pagat</i>	615,507.00 €	582,070.67 €	- 33,436.33 €	(5.43)
<i>Rrymaelektrike</i>	231,104.13 €	207,291.48 €	- 23,812.65 €	(10.30)
<i>Shpe. e derivateveve</i>	26,862.52 €	19,341.93 €	- 7,520.59 €	(28.00)
<i>Miremb. Dheriparimet</i>	45,758.06 €	52,883.45 €	7,125.39 €	15.57
<i>Miremb, e automjeteve</i>	20,823.03 €	9,418.76 €	- 11,404.27 €	(54.77)
<i>Shpen. E taksave</i>	24,823.09 €	27,291.75 €	2,468.66 €	9.95
<i>Kemikalet</i>	4,972.79 €	4,174.31 €	- 798.48 €	(16.06)
<i>Shpenzimet tjera</i>	97,236.17 €	74,903.25 €	- 22,332.92 €	(22.97)
<i>Uji I pafaturuarnë m3</i>	2,162,625	2,100,131	(62,494)	(2.89)
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	54.64	54.87	0.23	0.42
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	275.06	270.08	-0.04	
<i>Mbulimioperativ</i>	1.18	1.25	0.07	
	187,947.02 €	239,742.31 €		

KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

2.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Kemi nje faturim me te vogel ne krahasim me TM paraprak , pasi qe ne muajin dhjetor 2020 me kerkese te nje numri te konsumatoreve institucional qe te parapaguajn shpenzimet e tyre, kemi bere rritjen e sasise se faturuar ndersa ne janar dhe shkurt faturimi I tyre eshte zero deri ne barazimin e gjendjeve.

Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.

Me kujdes të shtuar, janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit.

2.1.2 RAPORT I INSPEKTIMIT DHE SHKYÇJES

- Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet jane te prezentuara ne tabelen e meposhtme:

RAPORT I EKIPES SË INSPEKTIMIT

KRU"Hidroregjioni Jugor" sha

PERIUDHA

RAPORTUESE : TM1 2021

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmëruese per permbarim	Konsu mator et e legaliz uar	Lidhjet e paligjsh me te zbuluara	Nr. i shkyçje ve	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezu ara per gjykatë	Vizita nga ankesat/k erkesat konsumat oreve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	2,815	348	2	2	2,379	102	0	128	48,425.65
Suharekë	187	33	5	2	1,537	34	0	60	16,194
Malishevë	823	0	0	5	719	166	0	0	11,000
Dragash	0	5	0	0	0	0	0	0	130
TOTAL	3,825	386	7	9	4,635	302	0	188	75,749.65

2.1.3 RAPORT I ANKESAVE TEKNIKE DHE KOMERCIALE

Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.

Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	603
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	603
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	203
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	203
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	203

2.1.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Nje numer prej diku rreth 400 konsumatoreve ende shfrytezojn ujin pa ujemetes dmth nuk kane te vendosur ujemetesit qofte per shkaqe teknike apo edhe per arsye tjera, Pjesa tjeter e konsumatoreve prej 400-450 konsumatore kane ujemetesit jofunksional dhe lexuesit ne momentin e leximit nuk e dijn sasine te cilen duhet ta vendosin me rastin e leximit pasi qe shohin qe konsumatori shpezon ujin ndersa ujematesi nuk konton.

Mospagesa e obligimeve te kontraktuara nga nje pjese e madhe e konsumatoreve të cilët kanë nënshkru kontratë për pagesën e borxheve me kiste si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare te familjet e tyre nga Covid 19.

Vazhdon problematika e mos zgjidhjes së problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve. Ky numër vazhdon të rritet për çdo muaj dhe konsiderojm që ky numër në teren është mjaft i madh, sidomos gjatë kësaj periudhe të pandemisë.

Moszgjidhja e qështjes së borxheve të mëhershme, trashëgimi i borxheve në prona.

Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kan qenë nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Pronës.

2.1.5 MASAT E REALIZUARA/MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

Kane vazhduar punen, arka mobile dhe inkasimi nga inspektorati në njësin e Prizrenit dhe njesive tjera për pages te konsumatorët të cilët nuk kanë paguar mbi 6 muaj.

Vazhdon implementimi i Up-grade (avansimi i softverit), për faturim, arkat për pagesa dhe departamente tjera në Kompani.

Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyqje dhe legalizimeve.

Kemi një renie në inkasim në krahasim me muajin paraprak, si rezultat i mospagesës së obligimeve nga ana e konsumatorëve. Kjo renie ka ardh si rezultat i mospageses se obligimeve nga ana e institucioneve, pasi qe ende nuk jane leshuar mjetet nga thesari.

Aktivitete me përmbarues privat (dalja ne teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatoreve, trashëgimtarëve të tyre etj), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.

Nuk janë janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbarimore në terrenet e inkasantëve në qytet .

Jane vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste, mirepo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

2.1.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NË VAZHDIM

- Ne pajtim me masat nga Qeveria per Covid 19, do te vazhdohet me punët sipas normalitetit do të vijoje aktivitet si në vazhdim:
 - Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
 - Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.

- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit të konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve të përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta të konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles të konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat.
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit.

2.2 Aktivitet për zvoglimin e UPF-se

- **Identifikimi i konsumatorëve ilegal, legalizimi i tyre dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (lidhjeve ilegale dhe shfrytëzimit të paautorizuar të ujit);**

- Janë identifikuar, i është dhënë pëlqime dhe legalizuar 386 konsumatorë.
- Jane zbuluar dhe shkyq 7 ilegale gjatë periudhës raportuese.

- **Identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujë)**

- Nuk kemi procedu raste në gjykate.

III. KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR FINANCIAR

3.1 KOMENTET NGA SHËRBIMI FINANCIAR

3.1.1 AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR TM1 - 2021

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Përgatitja e raporteve tremujore për TM1 2021;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;

- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Gjithashtu edhe këtë tremujor kemi marrë masa për mbrojtje nda virusit Covid-19,
- Përgatitja e shënimeve, dokumentacionin për auditorët e ZKA-së,
- Përgatitja e draft pasqyrave financiare 2020,
- Deklarimet e nevojshme ndaj ATK-së
- Raportimet vjetore ndaj ARRU-së

3.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Për tre mujorin e I-rë, 2021

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e I-rë 2021, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të IV-të 2020, janë dukshëm më të ulta.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsytet e rritjes apo uljes së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi një ndryshim, shpenzimet për këtë kategori janë ulur, për arsye se në muajin dhjetor të vitit të kaluar, sipas vendimit të kryeshefit ekzekutiv, është ndarë shpërblim për të gjithë punëtorët e kompanisë dhe për këtë arsye shpenzimet e pagave të tremujorit të kaluar janë më të larta;

Edhe në pozicionin e energjisë elektrike, kemi rënje të shpenzimeve në këtë tremujor në krahasim më të kaluarin, për shkak se, sipas vendimi të qeverisë në pakon e mbështjës financiare ndaj pandemisë, të gjithë konsumatorët janë subvencionuar në energji elektrike;

Gjithashtu edhe te pozicioni i derivateve kemi një rënje të këtyre shpenzimeve, pasi që në tremujorin e kaluar, jemi furnizuar me derivate dhe dru edhe për ngrohje qendrore, si dhe sezoni dimror ka ndikuar në rritje të derivateve;

Ndërsa, te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi rritje të kësaj kategorie të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor kemi pasur më shumë intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar, sidomos njësia e Suharekës;

Por, te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve kemi rënje të këtyre shpenzimeve, pasi që në këtë tremujor nevoja për intervenime ka qenë më e ulët;

Shpenzimet e taksave janë me të larta në këtë tremujor, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë më të larta se sa në tremujorin e kaluar, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njejtë;

Edhe te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administratës, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë etj, kemi rënje të këtyre shpenzimeve, pasi që në këtë tremujor kemi pasur më pak shpenzimet e interesit dhe gjobat nga ATK;

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të ulta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyt e cekura më lartë. Pra, pozicioni i pagave, i energjisë elektrike dhe ai i shpenzimeve tjera kanë qenë disa pozicionet që kanë ndikuar më shumë në rënjen totale të shpenzimeve, për arsyt e cekura më lartë;

3.1.3 PROBLEMET DHE RREZIQET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Duke e parë gjendjen financiare në KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para tri problemeve të mëdha, respektivisht rreziqeve relativisht të mëdha:

1- Vendimi i ATK nr. 332/2019 dat.28.08.2019 lidhur me pagimin e borgjit ndaj ATK dhe atë : Obligimi për TVSH

- Borgji kryesor-----	292,274.94
- Ndeshkimet me interes----	220,258.96
	<hr/>
Gjithesëjt	551,533.90

2- Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borgjin e Kompanisë ndaj KEK .ne shumë prej

